



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

|                        |   |
|------------------------|---|
| DATË/A:                | 21.05.2024  |
| REFERENC-Ë:            | 24/386/MMPHI  |
| PËR/ZA/TO:             | "MINERAL", L.L.C. Gllogoc , Bazë për prodhimin e Betonit, Poklek, Komuna Gllogocit. |
| CC:                    | Komisioni për Leje Mjedisore  |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |   |
| NGA/OD/FROM:           | Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI                     |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për ndërprerje të procedurës administrative                                  |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "MINERAL", L.L.C. Gllogoc, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Poklek, Komuna Gllogocit, me Nr. Prot. 24/386/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

- Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative për operatorin, "MINERAL", L.L.C. Gllogoc, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Poklek, Komuna Gllogocit.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/386/MMPHI  
Datë: 21.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

Operatori, "MINERAL", L.L.C. Gllgoc, i **ndërpritet procedura administrative** për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Poklek, Komuna Gllgoc, në ngastrën, nr. P- 70315056-00176-0 , zona kadastrale Poklek, Gllgoc.



## A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore nga operatori, "MINERAL", L.L.C. Glllogoc, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Poklek, Komuna Glllogocit, në ngastrën e nr. P- 70315056-00176-0, zona kadastrale, Poklek, Komuna Glllogocit, Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM për seperacion;

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: 21.05.2024, konstatoi se operatori " Poklek, Komuna Glllogocit për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit, Poklek, Komuna Glllogoc në ngastrën e nr. P- 70315056-00176-0 , zona kadastrale Poklek, Glllogoc, nuk i plotëson kriteret e parapara për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë ne afatin kohorë të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **mbyll procedurën administrative**, në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Glllogoc;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;

- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.

